**VENDIM**
**Nr. 74, datë 6.12.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 47, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar , Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për sistemin e kontrollit të brendshëm", miratuar me vendimin nr. 67, datë 2.9.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 7, pika 2, togfjalëshi "ekspertëve kontabël të autorizuar" zëvendësohet me togfjalëshin "audituesit ligjor ose shoqërisë së auditimit";

b) Në nenin 8, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, përmbajtja e shkronjës "b" ndryshon si më poshtë:

"siguron që njësia e kontrollit të brendshëm t'i kryejë detyrat e saj në mënyrë të pavarur dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm;"

ii) Në pikën 1, shkronja "c", togfjalëshi "ekspertët kontabël të autorizuar" zëvendësohet me togfjalëshin "audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit, komitetin e kontrollit";

iii) Shkronja "e" e pikës 1, bëhet pika "2" e këtij neni, me përmbajtjen e mëposhtme:

"Komiteti i kontrollit mund t'i propozojë këshillit drejtues, emërimin ose shkarkimin e drejtuesit dhe punonjësve të njësisë së kontrollit të brendshëm.";

iv) Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Anëtarët e komitetit të kontrollit mund të jenë anëtarë të këshillit drejtues, si dhe kryetari i komitetit të kontrollit duhet të jetë në çdo rast anëtar i këshillit drejtues të bankës.";

c) Në nenin 12 shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Njësia e kontrollit të brendshëm zbaton standardet ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm, sipas përcaktimeve të ligjit "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar.";

d) Në nenin 14, pika 1, shkronja "a", pas togfjalëshit "në zbatimin e standardeve" shtohet togfjalëshi "ndërkombëtare";

e) Në nenin 15, pika 3, shkronja "e", kryhet ndryshimi i mëposhtëm:

i) Togfjalëshi "ekspertët kontabël të autorizuar" zëvendësohet me togfjalëshin "audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit";

ii) Pas nenit 22, shtohet neni 23 me përmbajtjen e mëposhtme:

[*] Interesat privatë të anëtarit të këshillit drejtues me bankën dhe/ose me aksionarin/ët që ushtron/jnë kontroll mbi bankën dhe/ose me drejtuesit ekzekutivë të bankës, të përcaktuara sipas nenit 44, pika 2 të ligjit për bankat janë:

- marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta ose të tërthorta të çdo lloj natyre,
- çdo marrëdhënie tjetër juridiko – civile,
- dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale,
- negocime të mundshme për punësim apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për administratorin në të ardhmen, pas lënies së detyrës si administrator, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës si administrator në bankë,
- angazhime në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura,
- marrëdhënie familjare ose të bashkëjetesës.

[*] Lutemi plotësoni përgjigjet në kutiza me "po" ose "jo". Në rast të plotësimit me "po" të jepen shpjegime për llojin e marrëdhënies së interesave privatë të anëtarit të këshillit drejtues sipas (*) më lart.".

"Neni 23
**Dispozitë kalimtare**

Bankat ndërmarrin masat e nevojshme për plotësimin e kërkesës së nenit 8, pika 3, të kësaj rregulloreje, brenda vitit 2018.".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Gent Sejko**